

Raport nga kampi veror për të rriturit me aftësi të kufizuar të ndryshme (grupi i III) “Ulqini 2005”

Nga 31 gusht – 12 shtator 2005

Mbështetur dhe financuar nga Onlus R. Bazzoni
Organizuar nga HandKOS i



Personeli:

Përgjegjës i kampit: Behxhet Binaku

Ndihmës përgjegjës: Idriz Ibriqi

Teknike mjekësor: Muharrem Ceji

Pjesëmarrësit: 50 persona

Për dallim nga grupi i parë (fëmijët) dhe grupi i dytë (personat me lëndime të palcës kurrizore), në këtë grup pjesëmarrja ka qene nga shoqata dhe persona me aftësi të kufizuar të ndryshme.

Struktura e pjesëmarrësve sipas nivelit të aftësisë së kufizuar ka qenë kjo:

Nga shoqata e të verbërve 4,

Nga shoqata e të shurdhërve 3,

Nga Klubi “Dëshira” me aftësi të kufizuara mendore 4,

Me aftësi të ndryshme të kufizuar 28,

Shoqërues 11

Struktura gjinore:

Meshkuj - 28

Femra - 22

- Stafi udhëheqës i grupit :

Gjatë tërë kohës sa ka zgjatë kampi stafi i grupit të tretë ka aplikuar programin e aktiviteteve të hartuar para nisjes për në kamp dhe mund të konstatohet se në përgjithësi aktivitetet e parapara kanë qenë të realizuara sipas dinamikës së programit. Secili anëtar i grupit ka qenë i ngarkuar me detyra të caktuara. Në përgjithësi mund të konstatohet së plani i aktiviteteve është realizuar me sukses dhe në mënyrë të paraparë.



- Transporti:

Udhëtimi ishte dy ditë. Transporti i pjesëmarrësve të grupit të tretë është bërë me autobus të Kompanisë transportuese – Shpejtimi Tours - nga Theranda. Edhe gjatë shkuarjes dhe ardhjes së pjesëmarrësve nga kampi nuk ka pasur asnjë problem gjatë rrugës. Në autobus përveç pjesëmarrësve të përcaktuar për kamp, ka pasur edhe 4 pjesëtarë të familjarëve të pjesëmarrësve të cilët nuk kanë qenë pjesëtarë të grupit të kampit, por me marrëveshje edhe të z. Halit ferizit dhe vozitësve të autobusit është lejuar që të shfrytëzojnë transportin për në Ulqin dhe anasjelltas.

- Prezentimi i aktiviteteve (Dita e parë data 01 shtator 2005)

Në mbrëmjen e ditës së parë, Afrim Maliqi (përgjegjësi i grupit të dytë) duke i bashkuar të dyja grupet grupin e dytë dhe të tretë i cili ndodhej në kamp prezantoi shkurtimisht historikun e HandiKOS-it dhe Organizatën Joqeveritare Onlus Bazzoni, si donator të këtij kampi. Gjithashtu ai foli edhe për rregullat dhe rolin e kampit në rehabilitimin e përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara. Behxhet Binaku, përgjegjës i grupit të tretë, gjithashtu i informoi pjesëmarrësit mbi detyrat dhe obligimet që duhet respektuar secili pjesëmarrës në mënyrë që kampi të jetë sa më aktiv dhe i tërë plani i aktiviteteve të shkon në interes të pjesëmarrësve.

Aktivitetet fizikale (Gjimnastika e mëngjesit) – 9,00 – 10,00

Pjesë e rëndësishme e planit të aktiviteteve ishte avancimi dhe mirëmbajtja e gjendjes fizike të pjesëmarrësve. Gjimnastika e mëngjesit e cila është aplikuar për çdo mëngjes, aktivitetet tjera fizike (qëndrueshmëria në duar, vrapim me këmbë të lidhura, shtytje e mjeteve të rënda metalike, lojërat e



basketbollit, ping-pongut etj kanë qenë pjesë e rëndësishme e avancimit të gjendjes fizike të pjesëmarrësve në kamp.

Duke ditur se struktura e pjesëmarrësve të grupit të tretë sa i përket niveleve të aftësisë së kufizuar ka qenë shumë heterogjene edhe aktivitetet fizikale kanë qenë të llojeve të ndryshme dhe numri i pjesëmarrësve (përdorues të karrocave ka qenë i vogël) gjithsejtë 5 është punuar edhe në mënyrën e përdorimit të karrocës, pikës ekulibruese, transferet nga karroca, zbritja dhe ngritja nga shkallet improvizuese.

- Plazhi 11,00 -17,00

Një numër i madh i pjesëmarrësve janë ballafaquar për herë të parë me ujën e detit dhe nuk kanë pasur njohuri në not, është aplikuar sistemi i futjes në ujë me përcjellës dhe janë demonstruar njohuri themelore të mësimit të notimit.

Në plazh janë zhvilluar edhe aktivitetet tjera fizike dhe kulturore (Psh. përfaqësuesit nga Shoqata e të Shurdhërve ka ekzekutuar pika humoristike dhe gara kërcim me këmbë të lidhura në rërë).

Vlen të theksohet se përveç tri ditëve të para të gjithë pjesëmarrësit në plazhë dhe në të gjitha aktivitetet tjera, kanë dalë në mënyrë të organizuar dhe të gjithë së bashku, përjashtuar përfaqësuesit të Shoqatës së të verbërve, të cilët prej fillimit e deri në fund të kampit, si në plazh ashtu edhe në të gjitha aktivitetet tjera kanë qëndruar ndaras nga grupi dhe nuk i janë bashkangjitur aktiviteteve të përbashkëta.

- Aktivitetet Sportive rekreative: 17,30 – 19,00

Për çdo ditë, në orët e pasdites janë aplikuar aktivitete sportive – rekreative si: ping-pong, basketboll, shah etj, por edhe plazh gjithashtu, lojëra të ndryshme.



- Seancat e Hapura – 20,00 – 21

Gjatë orëve të mbrëmjes sipas planit kemi aplikuar edhe seancat të hapura më pjesëmarrës, ku janë trajtuar tema të ndryshme të lidhura më interesin dhe jetën e personave me aftësi të kufizuar. Janë trajtuar këto tema: të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, është komentuar ligji mbi pensionet e personave me aftësi të kufizuar, është komentuar Rregullorja 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Kuvendeve Komunale, të drejta e qytetarëve në raport me Qeverinë Komunale. Është më rëndësi të theksohet se interesimi i pjesëmarrësve ka qenë shumë i lartë dhe pjesëmarrja e tyre ka qenë shumë aktive në të gjitha seancat.

- Dalja në Qytet

Dalja në qytet është bërë në mënyrë individuale por edhe ne grupe. Kjo është bërë sidomos në orët e mbrëmjes dhe vetëm në kohën kur nuk ka pasur aktivitete. Çdo pjesëmarrës së pari ka lajmëruar kohën e shkuarjes dhe kohën e qëndrimit në qytet.

Dua të theksoj se në ditën e parafundit të kampit me pëlqimin e stafit udhëheqës kam organizuar një shkuarje ne plazhin e vogël për 25 persona të cilët kurrë më parë nuk kishin dale ne Qytet dhe nuk kishin vizituar plazhin e vogël.

Rekreacioni:

Në ditën e tret të kampit së bashku me grupin e dytë, kemi organizuar mbrëmjen (party), ndërsa në mbrëmjen e fundit të kampit me vetë dëshirën e pjesëmarrësve është organizuar një mbrëmje argëtuese ku shpenzimet për organizimin e kësaj mbrëmje kanë qenë nga vetë pjesëmarrësit dhe një shumë e mbetur e të hollave nga mbrëmja e parë e organizuar me grupin e dytë.

Në mbrëmjet e dytë të këtij kampi përveç argëtimit dhe muzikës është zgjedhur edhe misi dhe misteri i mbrëmjes, janë recituar poezi dhe është prezantuar humor i larmishëm nga vetë pjesëmarrësit dhe mysafir nga Qyteti i Ulqinit.

- Kujdesi shëndetësor: Gjatë qëndrimit në kamp marrë në përgjithësi, nuk kemi pasur probleme serioze shëndetësore të pjesëmarrësve. Një rast nga Komuna e Dragashit me referimin e mjekut nga Qendra e Spitalit ne Ulqin, dy ditë para se të përfundoj kampi është dashur të kthehet në shtëpi sepse trajtimi është dashur të bëhet në Prishtinë në mënyrë urgjente. Ndërsa një rast tjetër për shkak të një lëndimi të mëhershëm, në gishtin e dorës është dashur të trajtohet disa ditë radhazi në ambulancën e Qytetit në Ulqin. Rastet tjera kanë qenë të lehta, kryesisht lëndime të lëkurës (djegëse) nga dielli dhe dhembje koke.

- Raporti i teknikut mjekësor, në detaje e pasqyron rrjedhën e gjendjes shëndetësore të pjesëmarrësve dhe intervenimet e nevojshme që janë bërë. Me këtë rast dua të theksoj, se kolegu nga Klubi Dëshira z. Muharrem Cej edhe pse nuk ka qenë i përcaktuar në rolin e teknikut të kampit për grupin e tretë, për 24 orë të tëra ka kryer detyrën e teknikut ne mënyrën me të mirë të mundshme. Ky njeri meriton lëvdata te veçanta, sepse jo vetëm si teknik, por edhe si staf ka kryer shumë detyra ne shërbim te pjesëmarrësve të kampit.

- Pengesat

Me përgjegjësi të plotë them se pengesë në realizimin e programit të kampit për Grupin e tretë ka qenë mungesa e makinës. Dua të ju përkujtoj se për pesë ditë radhazi znj. Florije Azemin, kolegu Hajriz, e ka dërgua ne Ambulancën e Qytetit ne Ulqin me makinën e vetë. Gjithashtu, Hajrizi gjatë kësaj kohe me makinën e tij na ka ndihmuar shumë sidomos ne transportimin e shumë pjesëmarrësve në qytet, te mjeku dhe çështje tjera organizative që kishin të bënin me nevojat e pjesëmarrësve nga Qyteti deri ne Hotel.

- Sugjerime:
Sugjeroj që në të ardhmen Grupi i tretë të këtë teknik mjekësor me përvojë, makinë, kamerë dhe aparat fotografimi. Gjithsesi do të duhej që një person të përcaktohet që të gjitha ngjarjet në kamp të përcjell me shirit kamere dhe aparat fotografimi, sepse kujtoj se këto janë dokumente të rëndësishme që pasqyrojnë aktivitetet e gjalla në kamp.

Përgjegjësi i kampit
Behxhet Binaku